



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në Seancën e Përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 06/L-54), me datë 09 tetor, me shumicë votash, nxjerr këtë:

MENDIM JURIDIK

PËR

SHPËRBLIMIN E SHUJTËS DITORE, PAGËS SË 13-TË, SHITESAT NË PAGË PËR KUALIFIKIMIN SHKOLLOR DHE PAGËN JUBILARE NË POLICINË E KOSOVËS

- I. Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021.
- II. Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021.
- III. Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë nenit 29 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi

Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

- IV. Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës jubilarë për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11. 2018, në bazë nenit 29 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e pagës jubilarë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Arsyetimi i Mendimit Juridik

Gjykata Supreme e Kosovës nga praktika e saj, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët e vlerëson me interes dhënien e këtij mendimi juridik për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e çështjes së shpërblimit të shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesave në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagës jubilarë, periudhën kohore që duhet të aplikohen udhëzimet administrative, si dhe kushtet për të fituar të drejtat e cituara, në kontestet nga marrëdhëniet e punës për personelin e policisë.

Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë mendim juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat. Me nenin 27 të këtij ligji: përcaktohet se seanca e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka të drejtë në nxjerrjen e qëndrimeve parimore, mendimeve juridike dhe udhëzuesve që promovojnë zbatimin unik të ligjeve, ndërsa nevoja e adresimit të këtyre çështjeve përmes mendimit juridik ka rrjedhë si propozim dhe konkludim i Gjykatës Supreme, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore të gjykatave të instancave me të ulëta, si dhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët, e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore duke adresuar çështjet e sipër theksuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nxjerrja e këtij mendimi juridik do t'i kontribuojë në radhë të parë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjet e cituara me lartë, efikasitetit, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmëri e publikut në gjykata.

Arsyetimi për pikën I (një) të mendimit juridik – Është standard i së drejtës civile që ligji material do të vlejë në kohë të caktuar dhe territor të caktuar. Në këtë kontekst, përcaktohet edhe zbatimi i dispozitave të Ligjit për Policinë, nr. 04/L-076, Udhëzimi Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe Udhëzimi Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, duke marrë si bazë kohën e lindjes së marrëdhënieve juridike - civile dhe kohën e lindjes së kontesteve.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se a duhet të aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021.

Me nenin 44 të Ligjit për Policinë, përcaktohet se: “ 1. Policia e Republikës së Kosovës punëson tri kategori të personelit policor: 1.1. zyrtarë policorë që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t’i ushtrojnë dhe t’i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore; 1.2. staf civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtrojë autorizime policore; 1.3. kadet policor. 2. Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”. Ndërsa me nenin 55, paragrafi 1 pika 1.7 të këtij ligji, përcaktohet se: 1. Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore: 1.7. marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”.

Me nenin 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe neni 30 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, përcaktohet se: “ Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurimi shëndetësorë, për personelin e policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve nga praktika e saj, por edhe sipas parimit për zbatimin e ligjit material-gjegjësisht udhëzimeve administrative, përmes këtij mendimi juridik - në pikën I, vlerëson se në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat, për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11. 2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, për arsye se:

Nga përmbajtja e nenit 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe nenit 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, rezulton se përfshirja e shpërblimit të shujtës ditore është e karakterit deklarativ. Këto dispozita nuk përcaktojnë detyrime konkrete për punëdhënësin, por vetëm theksojnë se duhet të jenë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici. Nisur nga kjo, rezulton se në këto udhëzime administrative, çështjen e shpërblimit të shujtës ditore nuk e kanë përfshirë në pjesën detyruese si në paragrafin 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 29 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe paragrafit 3, 4 dhe 5 të nenit 30 të Udhëzimit

Administrativ nr.01/2021, ku janë përcaktuar edhe detyrimet për shpërblim, por jo detyrimi i shpërblimit për shujtë ditore. Gjithashtu nuk janë përcaktuar as kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës ditore.

Arsyetimi për pikën II (dy) të mendimit juridik - Arsyetimi për pikën II, të këtij mendimi juridik i referohet kontesteve nga marrëdhëniet e punës në lidhje me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se për kërkesat e shpërblimit të pagës së 13-të, a duhet të aplikohet neni 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe neni 30 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: në kontestet nga marrëdhëniet e punës në lidhje me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, personeli i policisë kanë të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka marrë për bazë faktin se me Udhëzimin Administrativ nr.01/2021, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, është shfuqizuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2018, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, mirëpo sipas kësaj gjykate, personeli i policisë kanë të drejtë që edhe për vitin 2021, të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e theksuara si më lartë, për arsye se neni 29 paragraf 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri më datën 29.09.2021, dhe ka qenë i karakterit detyrues, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021, të planifikojë mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore.

Udhëzimi Administrativ nr.01/2021, përkatësisht neni 30 paragrafi 2, ka përcaktuar se: "Personeli i Policisë, të cilët kanë marr vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore". Çka do të thotë se mënyrën si është formuluar dispozita, personelit të policisë i njihet e drejta në pagën e sipër theksuar nëse plotësohen kushtet e theksuara, mirëpo realizimi i shpërblimit është i kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, nuk lind me plotësimin e kushteve si vlerësimi i kënaqshëm dhe mos të qenët subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore, brenda vitit përkatës, por që e drejta në

shpërblimin e tillë, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara me udhëzimin administrativ të sipër-theksuar, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës, kur gjykata i jep mundësi për t'u deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore për shpërblimin e tillë.

Arsyetimi për pikën III (tre) të mendimit juridik – Arsyetimi për pikën III, të këtij mendimi juridik, i referohet kontesteve nga marrëdhëniet e punës - kërkesat për shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë, për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se për kërkesat e shpërblimit; për shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë, a duhet të aplikohet neni 29 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe neni 30 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: në kontestet nga marrëdhëniet e punës për shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë, për personelin e policisë, që kanë lindur pas datës 14.11.2018, në bazë nenit 29 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, personeli i policisë kanë të drejtë në shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, nëse plotësohen kushtet nga neni 29 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.02.2018, dhe neni 30 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ 01/2021.

Me nenin 29 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe me nenin 30 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, përcaktohet se: “ Shtesat në pagë për kualifikimin shkollor janë si në vijim: 3.1. diplomë universitare (bachelor, fakulteti) 0.5%, 3.2. master, magjistër i shkencave, 1%, dhe 3.3. doktoratë, PhD 2% ”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton qartë se nëse plotësohen kushtet e sipër theksuara, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë.

Arsyetimi për pikën IV (katër) të mendimit juridik - Arsyetimi për pikën IV, të këtij mendimi juridik, i referohet kontesteve nga marrëdhëniet e punës - kërkesave për shpërblimin e pagës jubilarë, për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë nenit 29 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se për kërkesat e shpërblimit; për shpërblimin e pagës jubilarë, a duhet të aplikohet neni 29 paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe neni 30 paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: në kontestet nga marrëdhëniet e punës për shpërblimin e pagës jubilarë, për personelin e policisë, që kanë lindur pas datës 14.11.2018, në

bazë nenit 29 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, personeli i policisë kanë të drejtë në shpërblimin e pagës jubilarë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, nëse plotësohen kushtet nga neni 29 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02.2018, dhe nenit 30 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ 01/2021.

Me nenin 29 paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 dhe me nenin 30 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, përcaktohet se: “ Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme të pune në Policinë e Kosovës, iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës për çdo 10 vite punë, pagë jubilarë ”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton qartë se nëse plotësohen kushtet e sipër theksuara, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e pagës jubilarë.

(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023)